



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 maj 2012
Nr. ref.: RK231/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 87/11

Parashtruesi

Ukshin Aliti

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.Nr.247/2007, të 12 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ukshin Aliti, banor i Gjilanit. Ai përfaqësohet nga avokati Gani Tigani.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjiilan për përcaktimin e të drejtave të tij pronësore për parcelat Nr. 1727 dhe 1728, të regjistruara në komunën kadastrale të Gjiilanit (në tekstin e mëtejme: pronë). Parashtruesi pohon që këtë pronë e ka trashëguar nga babai i tij i ndjerë, z. Riza Aliti. Më 10 janar 2007, Gjykata Komunale e miratoi kërkesëpadinë dhe vërtetoi se parashtruesi është pronar i pronës. Palët kundërshtarë në atë çështje ushtuan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan. Më 22 qershor 2007, Gjykata e Qarkut e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale dhe e refuzoi ankesën. Më 12 janar 2011, Gjykata Supreme e Kosovës i anuloi vendimet përkatëse të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut dhe e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit.
3. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta shqyrtojë vlefshmërinë kushtetuese të vendimit të Gjykatës Supreme dhe të lëshojë masë të përkohshme për të siguruar që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të mos ketë efekt ligjor nëse konstatohet se është ai marrë në kundërshtim me Kushtetutën.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 27, 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatën Kushtetuese), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatë më 29 qershor 2011.
6. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues) dhe Enver Hasani e Iliriana Islami.
7. Më 19 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Thuhet që babai i ndjerë i parashtruesit e kishte blerë pronën në vitin 1964 dhe kishte lidhur kontratë gojore për shitblerje. Prandaj, parashtruesi pohon që posedimi filloi prej vitit 1964 nga babai i tij pa ndërprerje, dhe më pas nga pasardhësit e tij, duke përfshirë parashtruesin, deri në vitin 1996 – 1997.
9. Gjykata Komunale në Gjiilan, me Aktgjykimin C.Nr.26/2004, të 10 janarit 2007, e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe vërtetoi se parashtruesi dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij ishin pronarë të pronës.
10. Gjykata e Qarkut në Gjiilan, me Aktgjykimin Ac.Nr.165/2007, të 22 qershorit 2007, e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e refuzoi ankesën e palës kundërshtarë.
11. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev.Nr.247/2007, të 12 janarit 2007, i anuloi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për pronë.

12. Parashtruesi pohon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 12 janarit 2011, i është dorëzuar më 13 prill 2011.
13. Gjykata Supreme e shqyrtoi gjendjen faktike të rastit dhe gjeti që gjykatat më të ulëta e kishin zbatuar gabimisht ligjin duke vendosur në favor të kërkesëpadisë së parashtruesit. Gjykata Supreme i shqyrtoi faktet në vijim:
 - a. Në bazë të raportit të ekspertit të gjeodezisë, të 2 gushtit 2000, prona ishte e regjistruar në emrin e KB “Mlladost” në vitin 1954-1955. Tani, prona është e regjistruar nën emrin e KM “Agrokultura”;
 - b. KB “Mlladost” dhe një palë e tretë “A” (emrat nuk tregohen) lidhën kontratë për ndërrimin e pronës së paluajtshme nr.804, të 28 korrikut 1997, e cila u vërtetua nga Gjykata Komunale në Gjilan (Vr.nr.1427/97, e 28 korrikut 1997);
 - c. Pala e tretë “A” (emrat nuk tregohen) lidhi kontratë për shitblerjen e pronës më 20 shtator 1997, e cila u vërtetua nga Gjykata Komunale në Gjilan (Vr.nr.1315/2000, e 11 korrikut 2000);
 - d. Prandaj, parashtruesi humbi posedimin e pronës në vitin 1996-1997 kur pala e tretë fitoi të drejtën pronësore mbi pronën;
 - e. Prona u rregullua nga pronari, pala e tretë, dhe shumë shtëpi u ndërtuan në të dhe disa u shitën më pas;
 - f. Kontrata gojore e shitblerjes që parashtruesi e konsideron si bazë të së drejtës pronësore është e pavlefshme pasi nuk i përmbush kriteret formale që kërkojnë me ligjin në fuqi për pronën e paluajtshme. Ligji në fuqi kërkon që kontratat e këtij lloji të jenë në formë të shkruar dhe të nënshkruara nga palët, dhe të vërtetuara në gjykatë. Nuk u përmbush asnjëri kriter për kontratë të vlefshme;
 - g. Gjykata Supreme nuk u pajtua me vendimin e gjykatave më të ulëta se parashtruesi i fitoi të drejtat pronësore përmes parashkrimit fitues;
 - h. Parashtruesi u bë mbajtës me mirëbesim i patundshmërisë nga momenti i trashëgimisë, që thuhet se ka ndodhur më 20 shkurt 1994, data e vdekjes së Riza Alitit. Gjykata Supreme tha me sa vijon: *“Paditësi si trashëgimtar bëhet mbajtës me mirëbesim të patundshmëris nga momenti i hapjes së trashëgimisë. Nga certifikata e vdekjes shifet se paraardhësi i paditësve Riza Aliti ka vdekur më 20.02.1994, ndërsa paditësit kanë humbur posedimin kontestues në vitin 1996-1997, aandaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga paragrafi 4 i nenit 28 i LMTHJP, që paditësit të fitojnë të drejtën e pronësis në pronën kontestuese me parashkrim.”*
14. Duke pasur parasysh situatën faktike të përshkruar më sipër, Gjykata Supreme konsideroi që ka pasur arsye për ndryshimin e aktgjykimeve të gjykatave më të ulëta.

Shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

15. Parashtruesi pohon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia shkel të drejtat e garantuara me Kushtetutë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës në përputhje me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës. Parashtruesi pohon që qasja e Gjykatës Supreme është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 80.6 (Hyrja në Fuqi e Ligjit) lidhur me nenin 102.3 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor), i cili thotë që *“Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”*. Parashtruesi e pohon këtë pasi koha e parashkrimit përfundoi gjersa vetë Riza Aliti ishte gjallë (1964 fillimi i kohës së

parashkrimit dhe posedimi i 20 vjetëve mbaron me vitin 1984), gjë që nuk kontestohet. Nga ky këndvështrim, parashtruesit i duket që qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është shumë i papranueshëm dhe jokushtetues.

Vlerësimi i masës së përkohshme

16. Sa i përket kërkesës së parashtruesit që Gjykata Kushtetuese të lëshojë masë të përkohshme për të siguruar që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të mos ketë efekt ligjor, kjo kërkesë nuk përmban prova apo arsye të mjaftueshme që mund ta justifikojnë vënien e masës së përkohshme.
17. Në veçanti, parashtruesi nuk ka treguar, siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit, se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse masa e përkohshme nuk vihet. Përveç kësaj, nuk është përcaktuar që vënia e masës së përkohshme do të ishte në interes publik.
18. Prandaj, kriteret për vënien e masës së përkohshme nuk janë përmbushur dhe kërkesa e parashtruesit duhet të hidhet poshtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë.
20. Në këtë drejtin, Gjykata i referohet nenit 53 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

22. Së fundi, Gjykata i referohet Rregullores së punës, sidomos:

a. Rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, sipas të cilit: *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartazi e bazuar.*

b. Dhe rregullit 36 (2) (b) dhe (d), sipas të cilit: *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

23. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj

kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

25. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim, ECHR Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
26. Sa i përket ankesës së parashtruesit për shkeljen e supozuar të nenit 46 të Kushtetutës, mbrojtja e pronës, si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, Gjykata rikujton që kjo zbatohet vetëm për posedimet ekzistuese të personit.
27. Prandaj, shpresa që e drejta në pronë që është shuar kaherë mund të rikthehet nuk mund të konsiderohet “posedim”, e as kërkesa me kusht që është parashkruar si rezultat i mospërmbushjes së kushtit (shih *Gratzinger dhe Gratzingerova* kundër Republikës së Çekisë (vendim) [DHM], nr. 39794/98, paragrafi 69, GJEDNJ 2002-VII). Megjithatë, në rrethana të caktuara, “pritja legjitime” e fitimit të një “pasurie” gjithashtu mund ta gëzojë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Prandaj në rastet kur interesi pronësor është në natyrën e kërkesës, mund të konsiderohet se personi në fjalë ka pritje legjitime nëse ka bazë të mjaftueshme për atë interes në ligjin vendës, p.sh. kur ka praktikë gjyqësore të përcaktuar nga gjykatat vendëse me të cilën vërtetohet ekzistimi i saj (shih *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], nr. 44912/98, paragrafi. 52, GJEDNJ 2004-IX). Megjithatë, nuk mund të thuhet që pritja legjitime mund të ndodhë nëse ka kontest lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit vendës dhe më pas parashtruesat e parashtruesit refuzohen nga gjykatat vendëse (shih *Kopecký*, cituar më lart, paragrafi 50).
28. Gjykata rikujton që në rastin në fjalë ka kontest lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit në fuqi dhe më pas parashtruesat e parashtruesit refuzohen nga Gjykata Supreme.
29. Prandaj, Gjykata është e kënaqur që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e justifikojnë pohimin për shkelje të së drejtës kushtetuese për mbrojtje të pronës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani